

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	21432700-23-14367-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Krijimi i sistemit për menaxhim e aktiviteteve të AME dhe NJPZSH**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Geo&Land sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bardhyl Qaushi 15/11, nr 7

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

038 739 193

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vesa Mekolli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@geoland-kosova.com

(Adresa elektronike)

30/04/2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datë 01.08.2024
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 23.08.2024
Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Vendimi i OSHP për kthim të tenderit në rivlerësim 13.03.2025
Njoftim për vendimin e rivlerësimit të tenderëve/eliminimin 17.04.2025
Kërkesa për rishqyrtim drejtuar AK 22.04.2025
Njoftimi për pezullimin e AP nga ana e AK 23.04.2025
Njoftimi për refuzim të ankesë për rishqyrtim 23.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Data e fundit për dorëzim të tenderëve është 23.08.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 14.08.2024 kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK në këtë aktivitet të prokurimit publik ka shkelur LPP, neni 7, dhe neni 15.1 dhe 69.

AK me datë 23.04.2025 ka publikuar vendimin për refuzim të kërkesës si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e pretenduara:

- ✓ Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar):
 - Neni 7 paragrafi 2;
 - Neni 8;
 - Neni 15
 - Neni 59
 - Neni 69
 - Neni 135
- ✓ Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 14.5;
- ✓ Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 21.7.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 11.03.2025, OSHP përmes vendimit me nr. 2024/0976 ka konstatuar shkelje serioze në procedurën e vlerësimit të ofertave dhe ka rekomanduar qartë rivlerësimin e tenderit nga një Komision i ri i mandatuar nga Autoriteti Kontraktues (AK).

Pavarësisht këtij vendimi të detyrueshëm, AK me datë 17.04.2025 publikoi “Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar”, ndërsa me datë 23.04.2025 nxori vendim për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim. Me këtë rast, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin zyrtar, por qasja na është ofruar vetëm pjesërisht – një shkelje e dispozitave të LPP-së dhe të drejtës për transparencë.

PRETENDIMI NR. 1 – Moszbatimi i vendimit të OSHP-së (shkelje e nenit 135 të LPP-së)

Vendimi i OSHP-së nr. 2024/0976, datë 11.03.2025, ishte i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues, siç përcaktohet në nenin 135 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP - Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar), i cili thotë:

“Vendimi i OSHP-së është i detyrueshëm për autoritetin kontraktues dhe palët në procedurë. Moszbatimi i vendimit përbën shkelje serioze të dispozitave të këtij ligji.”

Në kundërshtim me këtë dispozitë, AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të ligjshëm për themelimin e një komisioni të ri për rivlerësim, por ka vazhduar procedurën në kundërshtim me vendimin e OSHP-së, duke u bazuar në vlerësimin fillestar, tashmë i konstatuar si i paligjshëm.

PRETENDIMI NR. 2 – Mungesa e komisionit të ri të rivlerësimit dhe përvetësimi i procesit nga zyrtari i prokurimit (shkelje e nenit 59 të LPP-së)

Në kërkesën tonë për qasje në dokumentacion, kemi kërkuar në mënyrë të qartë:

- Vendimin për themelimin e komisionit të ri të rivlerësimit të ofertave, të nxjerrë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA);
- Procesverbalin e rivlerësimit të nënshkruar nga anëtarët e këtij komisioni.

AK nuk ka ofruar asnjë vendim zyrtar për themelimin e këtij komisioni, dhe procesverbali i ofruar nuk është i nënshkruar nga asnjë anëtar i ndonjë komisioni, duke treguar qartë se rivlerësimi nuk ka ndodhur nga komisioni, por është bërë në mënyrë arbitrare vetëm nga zyrtari i prokurimit.

Ky veprim është në shkelje flagrante të nenit 59 të LPP-së, i cili përcakton qartë:

“Vlerësimi i ofertave dhe/apo kërkesave për pjesëmarrje bëhet nga komisioni vlerësues i caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.”

PRETENDIMI NR. 3 – Vlerësim në kundërshtim me vendimin e OSHP-së dhe arsyetim i jashtëligjshëm për anulim të kontratës (shkelje e nenit 97/h të Rregullave të Prokurimit)

AK, në vend që të zbatojë vendimin e OSHP për rivlerësim, vazhdon me vlerësimin fillestar që është rrëzuar, dhe për më tepër, justifikon anulimin e procedurës për shkak të mungesës së buxhetit, argument që është hedhur poshtë nga vetë OSHP në vendimin nr. 2024/0976.

Ky veprim bie në kundërshtim me:

- Nenin 97 paragrafi h) të Rregullave për Prokurim Publik (RRPP), ku theksohet se:

“Mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së përbën shkelje të rëndë ligjore dhe mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi.”

- Si dhe nenin 59 dhe nenin 135 të LPP-së, që kërkojnë zbatim të plotë dhe të drejtë të vendimeve të OSHP-së dhe zbatimin e procesit të rregullt të rivlerësimit.

KËRKESË DREJTUAR OSHP-së

Duke u bazuar në faktet dhe provat e mësipërme, i kërkojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që:

1. Të konstatojë se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me vendimin nr. 2024/0976 të OSHP-së dhe ka shkelur nenin 135 të LPP-së;
2. Të urdhërojë AK që të zbatojë në mënyrë të plotë dhe të drejtë vendimin e OSHP-së, duke themeluar një komision të ri të mandatuar ligjërisht për rivlerësim;
3. Të shqyrtojë provat se rivlerësimi nuk është bërë nga ndonjë komision por nga zyrtari i prokurimit, në shkelje të nenit 59 të LPP-së;
4. Të kërkojë nga AK që të dorëzojë vendimin për emërimin e komisionit dhe procesverbalin e nënshkruar, për të vërtetuar përputhshmërinë me ligjin;
5. Të shqyrtojë shkeljen e nenit 97/h të RRPP dhe të ndërmarrë masa disiplinore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë të gjitha pretendimet tona ankimore. Bazuar në deklaratimet si më lartë, në argumentet e pakontestueshme që kemi ofruar, kërkojmë nga OSHP, si dhe në mbështetje të plotë në LPP-në dhe legjislacionin sekondar, të nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “Geo&Land” SH.P.K.
- II. **Urdherohet AK të zbatojë vendimin e OSHP 2024/0976**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e demit te percaktohet ne procedure ligjore
--

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) Vendimi i OSHP*
- c) një kopje e njoftimit për vendimin e AK.*
- d) një kopje e kërkesës për rishqyrtim*
- e) Dëshmite si rezultat i komunikimit me AK*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*